



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 159/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje dega në Kaçanik, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Kaçanik, për shkak të dëmtimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 09.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.10.2013, nga subjekti politik LVV dega në Kaçanik, në të cilën theksohet se posterat e kandidatit për Kryetar Komune në Kaçanik të kësaj lëvizje janë shqyer nga aktivist të PDK-së dhe se nga kjo pretendojnë se me këtë veprim ka shkelur nenin 33 pika a të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 3 pika a të Kodit të Mirësjelljes së Subjekteve Politike dhe nenit 3.6 për Rregullat Zgjedhore 13/2013, si dëshmi ka bashkangjitur disa fotografi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 04.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 07.10.2013, në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK. në të cilën deklaroi se ankesa në fjalë është e pabazë nga fakti se fotoja e ofruar si provë materiale nuk qartëson kohën kur ka ndodhur shkelja e supozuar, pastaj nuk jepen prova për dëshmitarët eventuale që kanë pare këto veprime të aktivistëve të PDK-së. Në përgjigje në ankesë mëtutje theksohet se veprimet e tilla janë duke i kryer vetë aktivistet e LVV-së.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se subjekti politik PDK ka dëmtuar posterat e kandidatit për kryetar të kësaj lëvizje PZAP-i i vlerëson si të pabazura dhe të pa argumentuara nga shkakut se nga fotografitë e ofruara si dëshmi të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk vërtetohet fakti ashtu siç pretendohet në ankesë

pasi që posterat e subjektit politik PDK, janë të vendosura nën posterat e kandidatës të LVV-së, një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova dhe dëshmi bindëse, dhe se një ankesë e tillë nuk mund të konsiderohet si e bazuar, prandaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 159/2013 më datën 09.10.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**



#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore*